

GJYKATA KOMUNALE NË KLINË

Kryetari i trupit gjykues:

Gjyqtari i EULEX-it Riku Jaakkola

29.07.2011

C.nr. 210/2009

Paditësit: Vukoje Rajic, Dolac, Klinë;
Vukmir Rajic, Celjije, Lajkovac, Serbia;
Zorka Kujundzic, Kotez, Palilua (Beograd), Serbi;
Të gjithë të përfaqësuar nga avokatja Jasmina Zupanjac

E Paditura: Nuriye Selimi, Prishtinë
e përfaqësuar nga avokati Ahmet Gjinovci

Çështja: Anulimi i kontratës së shitblerjes së pasurisë së patundshme,
Vlera e kontestit 5000 euro

Shqyrtimi kryesor: 02 Qershor, 06 dhe 20 Korrik 2011

AKTGJYKIM

Kërkesa APROVOHET. Kontrata e shitblerjes së pasurisë së patundshme e datës 15.10.2002, në lidhje me ngastrën kadastrale nr.3, në zonën kadastrale Dolac në Komunën e Klinës, me sipërfaqe prej 3122m2 dhe e nënshkruar në emër të Vukoje Rajic si shitës dhe Nuriye Selimi si blerëse, shpallet e pavlefshme.

Zyra Kadastrale në Klinë, urdhërohet që të fshij regjistrimin i bërë në bazë të dokumentit të rrejshëm dhe ta vendos pronën në e cekur në emër të së ndjerës Stanica Rajic.

ARSYETIMI

Sfondi i padiskutueshëm

Stanica Rajic (mbiemri i vajzërisë Vukanic) ka vdekur me 20 Tetor 1998. Sipas listës poseduese nr. 52 të ZK Dolac, Komuna e Klinës, e lëshuar me 21 Gusht 2002, ajo ka qenë pronarja e vetme e ngastrës kadastrale nr.3 me sipërfaqe prej 3122 m2. Paditësit Vukoje dhe Vukmir Rajic janë bijtë e së ndjerës Stanica Rajic. Zorka Kujundzic është e bija e Stanica Rajicit.

Sipas autorizimit, paditësit e këtij rasti, si trashëgimtar të Stanica Rajic e kanë autorizuar avokatin Ahmet Gjinovci që ta përmyll procedurën trashëgimore dhe kontratën e shitblerjes në lidhje me ngastrën kadastrale të përmendur më lartë. Sipas këtij dokumenti, ka qenë e verifikuar nga Gjykata Komunale në Jagodinë në Serbi me 17 Prill 2002 (OV.nr.6123/2002).

Gjykata Komunale në Klinë, me 11 Tetor 2002 ka lëshuar një aktvendim në lidhje me trashëgiminë dhe ka deklaruar se Vukoje Rajic është trashëgimtari i vetëm i së ndjerës Stanica Rajic. Gjykata e ka bazuar vendimin e saj, kryesisht në autorizimin e sipërpërmendur.

Sipas një kontrate të shitblerjes së pasurisë së patundshme, e datës 15 Tetor 2002, Vukoje Rajic e ka shitur parcelën në pyetje dhe atë Nuriye Selimit.

Padia

Paditësit janë duke kërkuar se kontrata e shitblerjes e pasurisë së patundshme e datës 15/10/2002 dhe duke konsideruar ngastrën kadastrale nr.3 në zonën kadastrale Dolac në Komunën e Klinës, me sipërfaqe prej 3122 m², të deklarohet e pavlefshme. Paditësit po ashtu janë duke kërkuar që zyra kadastrale në Klinë të urdhërohet që të bëjë fshirjen e regjistrimit i bërë në bazë të dokumentit të të rrejshëm dhe që ta kthejë pronën në pyetje në emër të së ndjerës Stanica Rajic.

Bazat për padinë

Paditësit janë trashëgimtarë të së ndjerës Stanica Rajic. Si trashëgimtarë të saj, ata janë po ashtu edhe pronarët e vërtetë të parcelës së cekur. Kontrata e shitjes e datës 15/10/2002 dhe po ashtu edhe procedura e trashëgimisë në Gjykatën Komunale në Klinë janë përmbyllur pa dijeninë e paditësve dhe duke përdorur autorizim të rrejshëm. Paditësit nuk e kanë nënshkruar këtë autorizim.

Përgjigja

E paditura e ka kontestuar këtë padi. E paditura po ashtu ka kërkuar që paditësit janë të obliguar që të ia kompensojnë asaj shumën e shpenzimeve procedurale që është 603,06 euro.

Bazat për përgjigje

Së pari, autorizimi dhe kontrata e shitjes në fjalë, të dyja janë reale dhe valide. Paditësja po ashtu ka paguar çmimin e shitjes paditësve.

Së dyti, nëse autorizimi është i falsifikuar, ashtu si pretendojnë paditësit, po ashtu edhe procedura trashëgimore nuk është e vlefshme. Andaj, procedura trashëgimore nuk është e përfunduar dhe se paditësve u mungon legjitimiteti aktiv për të vazhduar me rastin.

Historia procedurale

Përmes vendimit të gjykatësit të EULEX-it, i cili ka vepruar si i deleguar nga Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të Eulex-it me 04 Nëntor 2010, rasti i është caktuar Gjyqtarit të Eulex-it Riku Jaakkola.

Trupi gjykues ka kryer dy seanca preliminare me 01 Mars dhe 20 Prill 2011. Sipas padisë origjinale të datës 03 Gusht 2009, ka pasur vetëm një paditës dhe atë Vukoje Rajic. Pas seancës së dytë preliminare, padia është ndryshuar dhe po ashtu edhe Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic i janë bashkangjitur padisë.

Në seancë me 01 Mars 2011, gjykata ka lëshuar një aktvendim për përjashtim nga shpenzimet e procedurës në lidhje me paditësin Vukoje Rajic (shiko procesverbalin e shqyrtimit të 01 Marsit 2011, fq 5 dhe 2o të 20 Prillit fq 2). Në shqyrtimin e 20 Prillit 2011, gjykata ka lëshuar një aktvendim për përjashtim nga shpenzimet e procedurës në lidhje me paditësit Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic (shiko procesverbalin e shqyrtimit të 02 Qershorit 2011, fq 3).

Në seancën e 20 Korrikut 2011, paditësit kanë tërhequr kërkesë padinë se e paditura urdhërohet që të dorëzojë pronësinë e ngastrës kadastrale në pyetje.

Gjykata po ashtu ka lëshuar një aktvendim për korrigjim të padisë me 25 Nëntor 2010 dhe aktvendimet për dëshmi eksperte nga grafologjia.

Lista e dëshmive

Në listën e mëposhtme, së pari është përmendur se cila palë i ka prezantuar dëshmitë. Pas titullit të dëshmive, është përshkrimi se çfarë kjo dëshmi pretendon të vërtetojë.

Dëshmitë e dokumentuara

Paditësit:

- 1) Kopje e listës poseduese nr. 52 e lëshuar me 21 Gusht 2002
 - Prona në pyetje është regjistruar në emër të Stanica Rajic
- 2) Kopja e listës poseduese e lëshuar me 15 Shkurt 2008
 - Pas kontratës së shitblerjes, pronë është regjistruar në emër të së paditurës
- 3) Kontrata për shitblerjen e pronës e datës 15 Tetor 2002
 - Kontrata është bërë me autorizim te rrejshëm
- 4) Autorizimi 17 Prill 2002, OV.nr. 6132/02
 - Dokumenti është i falsifikuar
- 5) Aktvendimi mbi trashëgiminë i Gjykatës Komunale në Klinë T 36/2002
 - Është përdorur autorizimi i rrejshëm për ta marrë këtë aktvendim
- 6) Letër përgjigje nga Gjykata Komunale në Jagodinë , 16 shkurt 2011
 - Autorizimi është i falsifikuar.

- 7) Dokumenti original i regjistruar si OV.no. 6132/02 në Gjykatën Komunale në Jagodinë
 - Autorizimi është i falsifikuar.
- 8) Certifikatat e lindjes së të paditurve
 - Paditësit janë trashëgimtarët e Stanica Rajic

Dëgjimi i paditësve

- 1) Vukoje Rajic
- 2) Vukmir Rajic
- 3) Zorka Kujundzic

Dëshmitarët

- 1) Arbon Desku
 - Kontrata ka qenë reale dhe çmimi i blerjes është paguar.
- 2) Kujtim Hoxha
 - Kontrata ka qenë reale dhe çmimi i blerjes është paguar.

Dëshmitari ekspert

Të paditurit:

1. Ekspertja e grafologjisë, Nadire Ibrahimimi (po ashtu raporti me shkrimi i ekspertes)

Vlerësimi faktit dhe ligjor

Hyrje

Nenet 26, 28, 89 dhe 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (SFRJ 29/1978, më tutjeonë LMD) jep bazat ligjore për këtë rast. Sipas nenit 26 '' pasi që palët kontraktuese kanë ardhur në marrëveshje në lidhje me një kontratë, ajo do të lidhet sipas elementeve thelbësore konstituive (kushteve) të kontratës''. Neni 28 paraqet elementin kryesor të një marrëveshjeje: shprehjen e vullnetit për të hyrë në kontratë. Kontrata nuk ekziston pa pasur shprehjen e vullnetit apo dëshirën për ta lidhur kontratën. Një person mund ta bëj një kontratë po ashtu duke lëshuar një autorizim një personi tjetër sipas nenit 89 të LMD.

Në këtë rast është e qartë se, nëse kontrata është lidhur me një autorizim të rrejshëm, pa dijeninë e paditësve dhe nëse paditësit nuk e kanë pranuar çmimin e shitjes, në fakt, asnjë marrëveshje nuk ekziston në mes të palëve sipas neneve 26 dhe 28 të LMD. Andaj, kontrata është në

kundërshtim me rregullat e detyrueshme dhe duhet që të shpallet e pavlefshme sipas nenit 103 të LMD.

Gjykata vë në dukje se paditësit kanë një grumbull provash se autorizimi ka qenë i falsifikuar. E paditura ka argumentuar se ajo ia ka paguar çmimin e blerjes paditësve dhe andaj ajo ka provë që paditësit i kanë pranuar të hollat.

Në rast se autorizimi dëshmohej që është i falsifikuar, po ashtu duhet që të vendoset se a e kanë paditësit legjitimitetin aktiv që të vazhdohet me rastin, meqë po ashtu edhe procedura trashëgimore është e bazuar në autorizim të rrejshëm.

Dëshmitë

Të gjithë *Paditësit* kanë dëshmuar se ata nuk e kanë nënshkruar autorizimin (dëshmia nr.4) dhe se ata nuk kanë qenë në dijeni në lidhje me kontratën mbi shitblerjen (dëshmia nr.3). Ata po ashtu nuk kanë pranuar kurrfarë të hollash për parcelën po ashtu. Vukoje Rajic ka mësuar për këtë marrëveshje kur ai e ka vizituar parcelën për herë të parë pas luftës në vitin 2008. Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic atëherë kanë mësuar për shitjen nga Vukoje Rajici.

Dëshmitari Arbon Desku ka dëshmuar se ai ka qenë i përfshirë në kontraktimin e shitjes së cekur. Ai e ka njohur blerësen Nuriye Selimi, e cila e ka kontaktuar atë dhe i ka thënë që ajo ka dëshirë që ta blejë parcelën në pyetje. Arbon Desku e ka kontaktuar një avokate të quajtur “ Zlata” me të cilën ai kishte kryer punë edhe më parë, dhe kishte pyetur nëse ajo mund ti kontaktonte pronarët e asaj parcele.” Zlata” atëherë, ka kontaktuar pronarët e asaj parcele dhe është lidhur një marrëveshje. Ai nuk është takuar me shitësit. Sipas Arbon Deskut, njëri nga pronarët, emrin e të cilit ai nuk mund ta mban në mend, e ka kontaktuar atë me telefon nga Obiliqi dhe e ka pyetur nëse kontrata mund të lidhej pa ndonjë avokat meqë ata kushtojnë shumë. Arbon Desku është përgjigjur se meqë ai është vetëm “ndërmjetës”, ai nuk pranon asgjë pa një avokat. Arbon Desku po ashtu ka paguar çmimin e shitjes në emër të Nuriye Selimit. Çmimi është paguar në pikën e kalimit kufitar në Merdare në dy raste. Ai ia ka dorëzuar paratë “Zlatës” e cila ka qenë e shoqëruar nga dy burra të cilët ai nuk i ka njohur. Çmimi i shitjes është paguar në monedha DM (marka gjermane). Po ashtu Vilson Quni dhe Kujtim Hoxha kanë qenë prezent. Arbon Desku nuk e ka identifikuar asnjërin nga paditësit si personat të cilët i kanë pranuar paratë. Ai po ashtu ka dëshmuar se ai nuk i ka takuar asnjërin nga shitësit në asnjë fazë.

Dëshmitari Kujtim Hoxha ka dëshmuar se ai ka qenë me Arbon Deskun dhe një person tjetër kur ata ia kanë dorëzuar paratë një gruaje, emrin e së cilës ai nuk e mban në mend. Kjo grua ka qenë e shoqëruar nga dy burra. Kujtim Hoxha nuk ka mundur që ta përshkruaj personin në vendngjarje dhe ai nuk ka mundur që t’ i identifikojë asnjërin nga paditësit që të jetë njëri nga personat. Ai tha se Vukoje Rajic duket diçka si i njohshëm, por ai nuk ka mundur që ta identifikojë se ku e ka parë ai atë.

Paditësit kanë ofruar si dëshmi *autorizimin* në pyetje (dëshmia nr.4), *letrën nga Gjykata Komunale në Jagodinë* 16 Shkurt 2011 (dëshmia nr.6) dhe dokumentin real të regjistruar si OV.nr. 6132/02 Gjykata Komunale në Jagodinë (dëshmia nr.7).

Trupi gjykues vë në pah se numrat personal të identifikimit të Vukoje Rajic dhe Zorka Kujundzic nuk përputhen me numrat e identifikimit të dhëna në autorizim, ndërsa numri personal i identifikimit i Vukoje Rajicit, përputhet. Numrat e identifikimit të paditësve janë kontrolluar në seancë nga origjinalet e letrave të tyre të njoftimit. Sipas autorizimit, numri personal i identifikimit të “ Rajic Mitra Vukmir” është 27056539344995, përderisa numri i saktë është 0107956934981. Sipas autorizimit, numri personal i identifikimit të “ Kojundzic Rajic Mitra Zorica” është 1012964937016, përderisa numri i saktë është 1012964959988. Trupi gjykues vëren se shtatë shifrat e para të numrit personal të identifikimit tregojnë datën e lindjes, kështu që Vukmir Rajic ka lindur me 01/07/1956 dhe Zorka Kujundzic ka lindur me 10.12.1964. Trupi gjykues po ashtu vëren se këto shtatë shifra të parë janë në rregull sa i përket Zorka Kujundzicit, por jo të sakta sa i përket Vukmir Rajicit. Për më tepër, trupi gjykues vëren se Zorka Kujundzic quhet “ Zorica” në këtë autorizim, edhe pse ky nuk është emri i saj i vërtetë.

Në lidhje me vërtetimin e autorizimit në pyetje, trupi gjykues vëren se ky dokument është vërtetuar me numrin OV.no. 6132/02 në Gjykatën Komunale të Jagodinës. Sipas një letre nga sekretarja e gjykatës në Gjykatën Komunale në Jagodinë (dëshmia numër 6) rasti që është regjistruar nën numrin OV.no. 6132/02 nuk ka të bëjë me autorizimin në pyetje. Kjo mund të vërehet edhe nga dokumenti real i vërtetuar me këtë numër (dëshmia nr.7)

Grafologja eksperte, Znj. Nadire Ibrahim i ka studiuar nënshkrimet në autorizimin në pyetje (dëshmia nr.4) dhe i ka krahasuar ato nënshkrime me mostrat e dorëshkrimit nga paditësit. Sipas dëshmisë së saj dhe raportit me shkrim, ajo i ka analizuar nënshkrimet dhe mostrat duke kërkuar për ndonjë karakteristikë individuale dhe të përbashkët në lidhje me, për shembull formulimin e shkronjave (tatëpjetësinë, madhësinë dhe lartësinë e shkronjave), hapësirat në mes të shkronjave, pozicioni i pikës fillestare dhe drejtimi i dorës gjatë shkruarjes. Ajo ka bërë gjetjet në vijim:

- Nënshkrimi nr.1 i “ Rajic Mitra Vukmir” në autorizimin (dëshmia numër 4) *nuk është* shkruar nga ana e personit të njëjtë sikurse në mostrat e dorëshkrimit të Vukmir Rajicit.
- Nënshkrimi nr.2 i “ Kojundzic Rajic Mitra Zorica” në autorizim (dëshmia nr. 4) *mund* të jetë i shkruar nga personi i njëjtë sikurse në mostrat e dorëshkrimit të Zorka Kujundzic.
- Nënshkrimi nr.3 i “Rajic Mitra Vukoje” në autorizim (dëshmia nr.4) *është* i shkruar nga personi i njëjtë sikurse në mostrën e dorëshkrimit të Vukoje Rajic.

Vlerësimi i dëshmimeve

Trupi gjykues vëren se dëshmitë e prezantuara janë pjesërisht kontradiktore. Trupi gjykues gjen se letra nga Gjykata Komunale e Jagodinës e datës 16 Shkurt 2011 (dëshmia numër 6) dhe

dokumenti real i regjistruar si OV. Nr. 6132/02 në Gjykatën e Qarkut në Jagodinë (dëshmia numër 7) dëshmojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se së paku regjistrimi në këtë autorizim në fjalë (dëshmia numër 4) është i falsifikuar. Kjo është po ashtu një indikacion i qartë se nënshkrimet në autorizim janë të rrejshme. Po ashtu edhe fakti që numrat personal të identifikimit të Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic nuk janë të sakta në autorizim, tregon se ky dokument nuk është nënshkruar nga Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic. Për më tepër tregon se personi i cili i ka falsifikuar këto nënshkrime nuk ka qenë në dijeni për numrat personal të identifikimit të këtyre dy paditësve. Fakti që të gjitha shifrat e numrit të identifikimit të Vukmir Rajicit nuk janë të sakta dhe të shtatë shifrat e para të numrit të identifikimit të Zorka Kujundzic janë të sakta, tregon që personi i cili i ka falsifikuar këto nënshkrime ka qenë në dijeni për datën e lindjes së Zorka Kujundzicit, por nuk ka qenë në dijeni për datën e lindjes së Vukmir Rajicit.

Në anën tjetër, dëshmia dhe raporti me shkrim i ekspertes së grafologjisë, Znj. Ibrahim, është konfuz. Sipas raportit të ekspertizës, nënshkrimet e Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic janë të falsifikuara, ndërsa, nënshkrimi i Vukoje Rajic është autentik. Po ashtu fakti se numrat personal të identifikimit të Vukoje Rajic të dhëna në autorizim janë korrekt, por dy të tjerat nuk janë korrekt, e mbështesin këtë konkluzion. Megjithatë, ende nuk shihet që të ketë ndonjë kuptim se nënshkrimi i Vukoje Rajic do të ishte autentik dhe nënshkrimet e dy paditësve tjerë të jenë të rrejshëm. I vetmi sqarim disi i arsyeshëm për këtë do të ishte që Vukoje Rajic është përgjegjës për falsifikimin e nënshkrimeve të Vukmir Rajicit dhe Zorka Kujundzicit. Megjithatë, është e pamundur se ai do të kishte bërë gabim në lidhje me numrat e identifikimit të vëllait të tij Vukmir Rajic dhe motrës së tij Zorka Kujundzic- do të kishte qenë e lehtë për të që të kontrolloj numrat e saktë të identifikimit. Posaçërisht e pamundur do të ishte që ai ta bëj këtë gabim në lidhje me shtatë shifrat e para të numrit të identifikimit të Vukmir Rajicit meqë këto numra tregojnë datën e lindjes së personit- është shumë e pamundur që ai të mos dijë as edhe vitin e lindjes së vëllait të tij. Po ashtu edhe fakti që “Zorka” është quajtur “Zorica” tregon që kush do që e ka shkruar atë autorizim nuk ka qenë në dijeni për emrin e vërtetë të Zorka Kujundzicit. Në rast se Vukoje Rajic nuk e ka falsifikuar këtë dokument, mundësi tjetër do të ishte që ndokush ka gjetur ndonjë dokument autentik të nënshkruar nga Vukoje Rajic dhe e ka kopjuar atë nënshkrim me shumë mjeshtri në këtë autorizim në fjalë. Trupi gjykues gjen se është e mundur që të kopjohet nënshkrimi aq mirë aq sa edhe eksperti i dorëshkrimit të mos e vërej falsifikueshmërinë. Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e lartpërmendur, trupi gjykues gjen se është mjaft e pamundur që Vukoje Rajic të jetë i përfshirë në falsifikimin e nënshkrimeve të Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic.

Trupi gjykues vëren se nuk ka arsye për ta vënë në pyetje kredibilitetin e dëshmisë së dëshmitarëve Arbon Desku dhe Kujtim Hoxha. Dëshmitë e tyre dëshmojnë që e paditura Selimi Nuriye ka paguar çmimin e blerjes njëfarë avokateje femër emri i së cilës është “Zlata”. Në bazë të avokatit të së paditurës, Z. Ahmet Gjinovci, emri i plotë i kësaj avokateje është Zlata Miletic. Z. Gjinovci e ka pranuar autorizimin në fjalë nga ajo. Megjithatë, dëshmitë e Arbon Deskut dhe Kujtim Hoxhës as që japin indikacione që të paditurit kanë pranuar paratë. Asnjëri nga

dëshmitarët nuk e ka identifikuar asnjërin nga paditësit të jenë të përfshirë në ndonjë marrëveshje në asnjë mënyrë.

Konkluzionet

Në lidhje me nënshkrimet e Vukmir Rajicit dhe Zorka Kujundzicit, gjykata vëren se të gjitha dëshmitë e prezantuara i mbështesin dëshmitë e paditësve. Siç është thënë edhe më lartë, autorizimi në fjalë (dëshmia numër 4), letra nga Gjykata e Qarkut në Jagodinë e datës 16 Shkurt 2011 (dëshmia numër 6) dhe dokumenti real i regjistruar si OV.nr. 6132/02 në gjykatën e Qarkut në Jagodinë (dëshmia numër 7) dëshmojnë se regjistrimi i autorizimit është i rrejshëm. Fakti që numrat personal të identifikimit të Vukmir Rajic dhe Zorka Kujundzic dhe po ashtu emri i Zorka Kujundzic të jenë në mënyrë të gabuar të cekura, tregon që edhe nënshkrimet e tyre janë të falsifikuara. Për më tepër, dëshmia e ekspertës së grafologjisë është një dëshmi e fortë se këto nënshkrime janë të falsifikuara.

Në lidhje me nënshkrimin e Vukoje Rajic dëshmia është kontradiktore. Dëshmia e ekspertës së grafologjisë është një dëshmi e fortë se nënshkrimi i tij nuk është i falsifikuar. Në anën tjetër, fakti që regjistrimi i autorizimit është vërtetuar të jetë i rrejshëm është një indikacion i fortë se po ashtu edhe nënshkrimi i Vukoje Rajicit është i rrejshëm. Po ashtu edhe informacioni jo korrekt në autorizim në lidhje me Vukmir Rajicin dhe Zorka Kujundzicin tregojnë që Vukoje Rajic nuk ka qenë i përfshirë në këtë falsifikim. Për më tepër, nuk ka dëshmi tjetër që tregon se Vukoje Rajic do të kishte qenë i përfshirë në shitblerjen e pasurisë së patundshme në ndonjë mënyrë: e paditura as që ka thënë se ka takuar ndonjërin nga paditësit: dëshmitarët Arbon Desku dhe Kujtim Hoxha nuk e kanë lidhur Vukoje Rajicin me këtë shitblerje në asnjë mënyrë. Trupi gjykues gjen se kjo mund të shpije në një konkluzion: Vukoje Rajic nuk e ka nënshkruar autorizimin. Andaj, në kundërshtim me mendimin e ekspertës, ka më shumë mundësi se po ashtu edhe nënshkrimi i Vukoje Rajicit është i falsifikuar, me siguri i kopjuar me mjeshtri nga ndonjë dokument tjetër që ai ka nënshkruar.

Legjitimiteti aktiv

E paditura ka argumentuar se nëse autorizimi do të del që është i falsifikuar, paditësit nuk e kanë legjitimitetin aktiv për të vazhduar me rastin meqë po ashtu edhe procedura trashëgimore nuk është valide.

Trupi gjykues vëren se meqë autorizimi është dëshmuar të jetë i rrejshëm, po ashtu edhe aktvendimi mbi trashëgiminë (T 36/2002) i Gjykatës Komunale të Klinës (dëshmia numër 5) është i bazuar mbi një dokument të rrejshëm. Edhe pse ky aktvendim nuk është anuluar ende dhe andaj është ende valid legalisht, trupi gjykues gjen se nuk mund të konsiderohet më tej si i detyrueshëm. Megjithatë, Paditësit nuk kanë kërkuar ndonjë gjë e cila do të kërkonte të kompletohet një procedurë trashëgimore. Sipas nenit 109 të LMD-së (Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore)“ Për nulitetin gjykata kujdeset kryesisht dhe atë mund ta invokoj çdo person i interesuar”. Trupi gjykues vëren se certifikatat e lindjes të paditësve (dëshmia numër 8)

dëshmojnë se ata janë trashëgimtarë të së ndjerës Stanica Rajic. Si trashëgimtarë të saj, paditësit kanë interes ligjor për ta parashtuar padinë në fjalë.

Konkluzioni përfundimtar

Mbi këto baza, trupi gjykues gjen se paditësit kanë legjitimitet aktiv për të vazhduar me rastin. Për më tepër, paditësit kanë dëshmuar se autorizimi në fjalë është i rrejshëm. Andaj, avokat Ahmet Gjinovci nuk ka qenë i autorizuar siç duhet për ta përfunduar shitblerjen e pronës në pyetje (neni 89 i LMD-së). Si pasojë, po ashtu edhe elementi kryesor i kontratës, shprehja e vullnetit për të hyrë në kontratë mungon (neni 28 i LMD-së). Meqë e paditura nuk ka dëshmuar se paditësit kanë pranuar as çmimin e shitjes, asnjë nga elementet e kontratës nuk janë përmbushur dhe po ashtu asnjë kontratë nuk është konkluduar (neni 26 i LMD-së). Padia duhet që të aprovohet dhe kontrata e shitblerjes së pasurisë së patundshme duhet që të shpallet e pavlefshme (neni 103 i LMD-së).

KËSHILLA LIGJORE

Palët mund të parashtojnë ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Pejë përmes Gjykatës Komonale në Klinë brenda 15 ditëve nga dita kur kopja e aktgjykimit i është shërbyer palës.

Gjykata Komonale në Klinë, 29 Korrik 2011

Riku Jaakkola
Kryetar i trupit gjykues
Gjyqtar i EULEX-it

